

RAPORTI VJETOR 2016



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND



FONDI KOSOVAR PER GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

GUARANTEE AGREEMENT No. KCGF-06-16



FONDI KOSOVAR PER GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

PËRMBAJTJA

Përmbledhja Ekzekutive - Raporti nga Menaxhmenti	04
Fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve	08
Profili i Institucionit	10
Misioni	10
Vlerat Institucionale	12
Struktura Organizative	13
Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti	14
Menaxhmenti i FK GK-së	16
Institucionet Financiare	18
Performanca e FK GK-së	20
Struktura e Kapitalit	20
Përdorimi i Shërbimit të Garancive Kreditore	21
Pasqyrat Financiare të Audituar	26

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

RAPORTI NGA MENAXHMENTI

Viti 2016 shënon themelimin dhe fillimin e punës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (tutje FKGK), institucion i themeluar me qëllim të garantimit të portofolit të kredive nga institucionet financiare, i destinuar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe ato të mesme (tutje NMVM). Një iniciativë e tillë është përshëndetur nga të gjithë akterët aktivë në ekonominë e Republikës së Kosovës, sepse shënon një hap përpara në drejtim të mbështetjes së ndërmarrësisë private në vend e që konsiderohet një prej shtyllave më të rëndësishme në strategjinë e gjithëmbarshme të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Praktikat nga vendet në tranzicion kanë treguar që përmirësimi i kushteve e të bërit biznes dhe lehtësimi i qasjes në financa për NMVM-në është treguar përcaktues në fatin e zhvillimit ekonomik, në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe në përgjithësi

në promovimin e vlerave etike dhe demokratike në shoqërinë e atij vendi.

Hulumtimet e ndryshme gjatë viteve të fundit lidhur me ambientin ekonomik në Kosovë kanë identifikuar se Kosova nuk bën përjashtim nga vendet tjera në tranzicion, si dhe një nga barrierat që pengon zhvillimin e NMVM-së në Kosovë është qasja në financa, duke vënë në theks të veçantë posaçërisht rolin e kolateralit në kredimarrjen e NMVM-ve. Prandaj iniciativa e filluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe nga USAID-i, tre vjet më herët, me qëllim të evitimit të kësaj barriere, ka rezultuar në krijimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore si skemë garantuese për portofolat kreditore për institucionet financiare në Kosovë.



Një ide e tillë rezultoi shumë e qëlluar për vetë faktin që do të ndikojë në përmirësimin e ambientit të biznesit dhe më pastaj edhe në zhvillimin, edhe në rritjen aftësisë konkurruese të NMVM-ve në Kosovë.

Sot në përpilimin e raportit të parë vjetor për FK GK-në ne analizojmë të arriturat, në retrospektivë, nga viti i kaluar, të cilat kryesisht korrespondojnë në jetësimin juridik dhe në funksionalizimin operativ të institucionit.

Ndoshta mund të duket një punë e thjeshtë, mirëpo rrugëtimi drejt realizimit të një projekti të tillë nuk ishte aspak i lehtë dhe ngërthen në vete përballjen me shumë sfida.

Qysh në fillim, në fazat e para, pas krijimit të idesë për modelin e biznesit dhe për qëllimet e institucionit sfidë kryesore ishte se çfarë forme ligjore dhe organizative do të ketë institucioni, çfarë karakteristikash do të kenë garancitë e ofruara nga FK GK-ja dhe kush do të jetë ekipi që do t'i konkretizojë idetë fillestare, si dhe të marrë përgjegjësi aktive në menaxhimin e mëpastajmë të operacioneve të FK GK-së. Dizajnimi i modelit të skemës së garancive për kredi ishte punë e përbashkët e ekipit të stafit të FK GK-së, e asistencës teknike nga programi i USAID-it Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore, e eksperiencës së përfaqësuesve të komunitetit bankar, si dhe e palëve të tjera të interesit.

Përcaktimi i një strukture ligjore dhe organizative, duke u bazuar në praktikat më të mira të qeverisjes korporative, përveç që ishte qëllim i përbashkët i të gjitha palëve të interesit, në vazhden e krijimit të një institucioni me bazë të shëndoshë paraqet edhe pikënisjen për draftimin e ligjit mbi të cilin do të themelohej Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

E gjithë kjo punë konkretizohet me procedimin e Ligjit për Themelimin e FK GK-së në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në dhjetor të vitit 2015, ndërsa në janar të vitit 2016 miratohet si ligj i veçantë, me ç'rast edhe krijon bazën ligjore për themelimin e FK GK-së si entitet i pavarur juridik. Po ashtu në dhjetor 2015, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA) ka transferuar në llogari të mirëbesimit të BQK-së, pjesën e parë të kontributit në kapitalin e FK GK-së, me ç'rast shënon hapin e parë në krijimin e bazës së kapitalit të FK GK-së.

Menjëherë pas miratimit të ligjit krijohen kushtet për fillimin e ndërtimit të strukturës korporative të FK GK-së, kështu që një muaj më vonë, në shkurt të 2016-s,

krijohet Bordi i Drejtorëve si organi më i lartë mbikëqyrës i FK GK-së. Po në këtë muaj mbahet edhe mbledhja e parë e Bordit, me ç'rast miratohet Statuti i FK GK-së si akti më i lartë brenda institucionit.

Në prill të 2016-s, në një ceremoni të organizuar nga USAID-i, përmes Programit Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore dhe Qeverisë së Kosovës, zyrtarizohet fillimi i punës së FK GK-së. Në këtë organizim, i cili edhe shënon krijimin e FK GK-së si institucion i pavarur, lokal, pjesëmarrës ishin instancat më të larta shtetërore, si: Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Kadri Veseli, Kryeministri i Kosovës z. Isa Mustafa, Ambasadori i SHBA-së në Kosovë SH.T. Greg Delawie, Ambasadorja gjermane në Kosovë SH.T. Angelica Veits dhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës z. Bedri Hamza.

Operimi i Fondit vazhdoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Bankën Qendrore të Kosovës në muajin prill të vitit 2016. Kjo marrëveshje përcakton bashkëpunimin në ndarjen e informacionit në mes të FK GK-së dhe BQK-së. Në muajin maj USAID-i hyn në marrëveshje me BQK-në për depozitimin e përkohshëm të mjeteve të destinuara për kontributin në kapital, në favor të FK GK-së, me ç'rast shënon edhe kontributin më të madh në bazën e kapitalit, për fillimin e garantimit të kreditimit.

Dizajnimi i aplikacionit për menaxhimin e bazës së të dhënave, përgatitja e materialeve promovuese, krijimi i uebfaqes dhe organizimi i takimeve me zyrtarët e bankave dhe me komunitetin e biznesit, me qëllim të informimit për rolin e institucionit dhe të shërbimeve që ofron, ishin aktivitetet që pasuan në muajt në vazhdim. Të gjitha këto ishin pjesë jo vetëm e nxitjes së aktiviteteve të Fondit, mirëpo edhe të krijimit të identitetit të institucionit.

Marrëveshjet e para me bankat u realizuan në muajin gusht, të cilat paraqesin edhe hapin final në të gjithë procesin, i cili do t'i paraprijë funksionalizimit operues të FKGGK-së. Kështu që deri në fund të vitit të parë 2016 FKGGK-ja realizoi marrëveshjet pothuajse me të gjitha bankat aktive në segmentin e NMVM-së, duke përfshirë: Raiffeisen Bank, ProCredit Bank, NLB Bank, Bankën për Biznes, TEB SH.A-në dhe Bankën Ekonomike.

Sipas këtyre marrëveshjeve, bankat do të kenë mundësi të transferojnë një pjesë të riskut kreditor të kredimarrësit si rezultat i pamjaftueshmërisë së kolateralit, si dhe do të mundësojnë qasje më të lehtë në financa për këto ndërmarrje.

Paralelisht me nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me bankat u organizuan një sërë seancash orientuese për bankat e regjistruara, me qëllim të informimit të stafit përkatës kreditor lidhur me FKGGK-në, për themelimin e tij, rolin, qëllimin, organizimin, parimet kryesore të garancisë kreditore, procesin e punës dhe qasjen në Sistemin për Menaxhimin e Informatave - MIS të FKGGK-së.

Po në muajin shtator regjistrohen edhe kreditë e para për garantim nga FKGGK-ja, duke shënuar mbase edhe ngjarjen kur të gjitha punët paraprake për përgatitjen e institucionit rezultojnë në funksionalizimin operues të tij. Ndërtimi i portofolit të garancisë kreditore vazhdoi në mënyrë sistematike, kështu që deri në fund të vitit FKGGK-ja garantonte 86 kredi, në vlerë prej 1.9 milion eurosh, duke mbuluar kështu shumën aktive të kredive të miratuara nga Institucionet Financiare të Regjistruara (tutje IFR) në vlerë prej 3.9 milionë eurosh.

Sikurse në çdo institucion tjetër, i cili është në hapat e para të funksionimit, sfidat e vërteta fillojnë tani. Zhvillimi i një institucioni të qëndrueshëm me reputacion, i cili reflekton besim të partnerët tanë, mbetet qëllim afatgjatë institucional. Po ashtu zhvillimi i portofolit të garancive dhe pjesëmarrja sa më aktive në lehtësimin e procesit të ndërmjetësimit financiar është "raison d'être", për të cilin është themeluar institucioni. Sidoqoftë, misioni për të cilin është themeluar institucioni na bën optimistë, njëherazi edhe përgjegjës në kontributin maksimal për realizimin e këtyre qëllimeve.

ITINERARI I AKTIVITETEVE TË RËNDËSISHME GJATË VITIT 2016:

2015 2016

DHJETOR	JANAR	SHKURT	PRILL	MAJ	GUSHT	SHTATOR
MTI (KIESA) transferon në llogarinë e mirëbesimit të BQK-së, pjesën e parë të kontributit në kapitalin e FKGGK-së	Miratohet Ligji për Themelimin e FKGGK-së, me këtë rast krijohet baza ligjore për themelimin e institucionit.	Konstituimi i Bordit të Drejtorëve si dhe miratohet Statuti i FKGGK-së	Ceremonia e zyrtarizimit të FKGGK-së Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të FKGGK-së dhe BQK-së	Marrëveshje në mes të USAID-it dhe BQK-së për Administrimin e Grantit për Kontribut në Kapital të FKGGK-së	Krijimi i MIS-it të FKGGK-së Nënshkrimi i Marrëveshjeve të para me Bankat	Regjistrimi i Kredisë së parë për garanci nga FKGGK-ja

FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Gjatë viteve të kaluara sektori financiar e në veçanti ai bankar në Kosovë ka pasur zhvillime inkurajuese, të cilat kanë kontribuar në masë të madhe në rritjen dhe në zgjerimin e aktivitetit të sektorit privat. Përderisa ka pasur rritje të vazhdueshme të aktivitetit kreditor për bizneset dhe për ekonomitë familjare, zhvillime pozitive ka pasur edhe në lansimin e produkteve të reja në treg, sidomos në drejtim të automatizimit të shërbimeve bankare, gjë që ka ndihmuar ndjeshëm në kualitetin e shërbimeve për qytetarët.

Në linjë me këto zhvillime pozitive për tregun financiar në Kosovë dhe me synimin që të lehtësohet qasja në financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në koordinim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me mbështetje të USAID-it, kanë bërë përgatitjet e nevojshme për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë.



Menjëherë pas themelimit të këtij institucion përmes aprovimit të ligjit përkatës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ndihmën e programit të USAID-it Fuqizimi i Mbështetjes Kreditorë, janë ndërmarrë të gjitha veprimet për t'u siguruar se FKGK-ja bëhet funksionale dhe fillon me ofrimin e produktit për garanci kreditorë sipas mandatit ligjor të tij. Dhe falë angazhimit të të gjithë partnerëve të përfshirë në proces: USAID-i, Qeveria e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Gjermane për Zhvillim-KfW dhe të partnerëve të

tjerë, FK GK-ja gjatë vitit 2016 filloi me lëshimin e garancive të para për përfitim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

Themelimi dhe operimi i FK GK-së me të drejtë ka krijuar pritje mjaft të mëdha nga të gjitha palët e interesit për kontributin, që pritet të ketë ky institucion në dinamizimin e mëtutjeshëm të sektorit bankar. Dhe në linjë me mandatin e tij ligjor Bordi i Drejtorëve të FK GK-së, duke pasur për bazë Ligjin për Themelimin e FK GK-së, rregulloret e BQK-së dhe të gjitha politikat dhe procedurat e FK GK-së, do të sigurohet se gjatë muajve dhe viteve në vijim FK GK-ja do të ketë një rol domethënës në tregun financiar në Kosovë. Përmes ofrimit të garancive kreditore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme FK GK-ja do të kontribuojë ndjeshëm në lehtësimin e qasjes në financa për këto biznese dhe kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen ekonomike të vendit dhe në gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Tani kur po përgatitet ky raport, pothuajse të gjitha bankat komerciale në vend janë regjistruar ose janë në proces të regjistrimit me FK GK-në dhe një numër i mirë i tyre ka filluar të shfrytëzojë produktin e garancisë kreditore, të ofruar nga FK GK-ja.

Duke pasur për bazë punën që është bërë deri më tani dhe orientimet tona për të ardhmen, jemi të bindur se të gjitha bankat do të shfrytëzojnë në maksimum mundësinë që ofron FK GK-ja për të lehtësuar qasjen në financim për NMVM-të.

Në kontekstin e pritjeve për të ardhmen, Bordi i Drejtorëve do të angazhohet që FK GK-ja të ketë një rol kyç në zhvillimin dhe në avancimin e mëtejshëm të sektorit financiar në Kosovë. Sipas mandatit të tij, Bordi i Drejtorëve do të sigurohet se FK GK-ja, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Themelimin e Fondit si një entitet juridik i pavarur, do të jetë një institucion kredibil dhe në kontekstin afatgjatë financiarisht i vetëqëndrueshëm.

Ashtu si deri më tani në rrugën drejt konsolidimit dhe avancimit të funksioneve të tij, FK GK-ja do t'i koordinojë aktivitetet me partnerët e tij, siç janë: USAID-i, Qeveria e Kosovës, KfW-ja, Banka Qendrore e Kosovës dhe partnerët e tjerë potencialë.

HAJDAR KORBI

Kryesues i Bordit të Drejtorëve


PROFILI I INSTITUCIONIT

Misioni

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

Përmes garantimit të portofolit kreditorë të institucioneve financiare, ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke i koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë, mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.





Vlerat Institucionale

Vlerat institucionale të FK GK-së, të cilat frymojnë brenda institucionit si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë, sigurojnë udhërrëfim që aktivitetet tona afariste do të kenë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë dhe do të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

TRANSPARENCA:

Duke qenë institucion në interes publik, FK GK-ja konsideron si shumë të rëndësishme shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikat dhe rezultatet financiare e operative me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI:

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në përgjegjshmëri me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkëta, ndërtim të besueshmërisë dhe respekt të ndërsjellë.

OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE:

FK GK-ja ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimarrje, duke u bazuar në arsye dhe në parime të shëndosha, duke nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar.

PËRKUSHTIMI:


Punonjësit e FK GK-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv, që institucioni do ta ketë në zhvillimin e shëndoshë ekonomik.

PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË:

FK GK-ja ka një ekip ekspertësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe të iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete është bazamenti i suksesit të FK GK-së.

Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin punëtor në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në këto parime.

STRUKTURA ORGANIZATIVE



BORDI I DREJTORËVE DHE MENAXHMENTI

Fondi Kosovar për
Garanci Kreditore, përmes
legjislacionit përkatës,
qeveriset nga një Bord
Drejtues në përbërje
prej shtatë (7) anëtarëve:

A. Një (1) anëtar sipas
detyrës zyrtare, i emëruar
nga Ministria e Tregtisë dhe
Industrisë e Republikës së
Kosovës;

B. Një (1) anëtar sipas
detyrës zyrtare, i emëruar
nga Ministria e Financave e
Republikës së Kosovës;

C. Katër (4) anëtarë të
pavarur, të emëruar nga
donatorët, dhe

D. Drejtori menaxhues i
FKGK-së.



HAJDAR KORBI, KRYESUES

Drejtor i Projektit të USAID-it
"Partneritet për Zhvillim"



BAHRIJE DIBRA

Koordinatorë e lartë e Sektorit për Financa dhe
Energji, Zyra e KfW-së në Prishtinë



BESIAN MUSTAFA

Drejtore i përgjithshëm, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës



SALVADOR ELMAZI

Drejtore i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës



BESNIK BERISHA

Drejtore Menaxhues i FKGK-së



KRESHNIK KURTISHI

Zv. Drejtore i Projektit të USAID-it "Partneritet për Zhvillim"

MENAXHMENTI I FKGGK-së



Nga e majta në të djathtë.

ARTA KRASNIQI

Këshilltare e Përgjithshme dhe
Sekretare e Bordit të Drejtorëve

BESNIK BERISHA

Drejtor Menaxhues

VJOSA KELMENDI

Menaxhere e Lartë e Financave
dhe Administratës

ALBAN KASTRATI

Menaxher i Lartë i Rrezikut

NORA ARIFI

Menaxhere e Lartë e Garancive

Ekipi i FK GK-së përbëhet nga profesionistë me mbi 10 vjet përvojë të mëparshme në institucione të ndryshme financiare apo publike. Ata janë plotësisht të vetëdijshëm për çështjet, të cilat prekin sektorin financiar në Kosovë, sistemin juridik, praktikat më të mira të huadhënies dhe kanë njohuri të thella për NMVM-të, natyrën, sfidat dhe mundësitë e tyre në treg. Të gjithë kanë kualifikime të duhura arsimore, në financa ose në drejtësi, në përputhje me kërkesat dhe natyrën e punës së tyre në FK GK.

Përveç kësaj, secili punonjës e konsideron veten si pjesë e një ekipi që ndan të njëjtat vlera dhe nxitet nga të njëjtat objektiva, për t'i shërbyer në mënyrë etike dhe profesionale interesave më të mira të institucionit dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

INSTITUCIONET FINANCIARE

FKGK-ja synon të ndërtojë një partneritet me të gjitha institucionet financiare, të cilat veprojnë në tregun lokal, duke përfshirë bankat, institucionet financiare jobankare dhe institucionet mikrofinanciare.

Fillimisht FKGK-ja filloi aktivitetin e saj me regjistrimin e bankave komerciale në programin e garancive, duke konsideruar që bankat kanë potencial më të madh për të zhvilluar një portofol, i cili do të ndihmonte FKGK-në t'i arrijë objektivat operuese si në aspektin kuantitativ, ashtu edhe në atë kualitativ.

Sektori bankar ka likuiditet të tepërt, në disa raste të investuar jashtë vendit me normë negative

të interesit, prandaj lehtësira e garancisë së FKGK-së mund të sigurojë zhblllokim të një pjese të konsiderueshme të këtij likuiditeti dhe ta kthejë atë në Kosovë, në të mirë të NMVM-ve të Kosovës. Kjo do të siguronte profitabilitet më të madh për bankat dhe do ta mundësonte FKGK-në që të bëhet institucion i qëndrueshëm financiar.

Procesi i regjistrimit të bankave në FKGK filloi në prill të 2016-s. Në fillim të majit të vitit 2016 bankat filluan t'i dorëzojnë dokumentet e tyre për regjistrim. Deri në fund të vitit 2016 janë regjistruar gjashtë banka dhe ato kishin të drejtë për të lidhur marrëveshje garancish me Fondin.

**Bankat e regjistruara në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore
në fund të 2016-s ishin:**

Banka për Biznes

NLB Bank

Raiffeisen Bank

Banka Ekonomike

ProCredit Bank

TEB SHA



PERFORMANCA E FK GK-së

Struktura e Kapitalit

Kapitali i FK GK-së në fund të vitit 2016 ishte në nivelin prej 7,345,141 eurosh, siç është përshkruar në tabelën në vijim:

Donatorët	Fondet fillestare të dhuruara	%
USAID-i	5,345,141.07	72,77%
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës	2,000,000.00	27,23%
Gjithsej	7,345,141.07	100,00%

Vlera e kapitalit e shumëzuar me faktorin pesë, dhe duke supozuar garanci prej 50% jep hapësirë për zhvillimin e biznesit të huadhënies deri në më së paku 73 milionë euro.

Kjo vlerë do të ishte portofoli maksimal i papaguar në çdo kohë të caktuar, por meqë FK GK-ja është limit revolvues, mbështetja potenciale dhe gjenerimi i kredive brenda një periudhe të caktuar mund të jetë shumë më e lartë.




Deri në fund të vitit 2017, me pranimin e mbështetjes së zotuar shtesë nga donatorët dhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kapitali i FK GK-së pritet të arrijë 10.7 milionë euro, duke forcuar edhe më shumë kapacitetin dhe fuqinë financiare të institucionit.

Përdorimi i Shërbimit të Garancive Kreditore

FKGK-ja ka filluar të pranojë kredi për garanci, nga institucionet financiare, në fund të shtatorit 2016. Pavarësisht periudhës së shkurtër kohore të mbetur të vitit 2016, FKGK-ja pati fillim të mirë në drejtim të ndërtimit të portofolit të garancive. Ky zhvillim pozitiv brenda një periudhe kaq të shkurtër kohore siguron optimizëm për rezultate më të mira dhe për zhvillim të planeve më ambicioze për vitin e ardhshëm.

Shuma e përgjithshme e kredive të miratuara nga IFR-të, që janë paraqitur për mbulim të garancisë gjatë vitit 2016, ishte 4.5 milionë euro, të shpërndara në 86 kredi; pjesa e garantuar ishte 2.1 milionë euro, duke lënë kështu hapësirë për zgjerim të ndjeshëm të portofolit të garancisë para se kapitali në dispozicion të jetë nën presion.


KREDITË E MIRATUARA



Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, të miratuara për garanci në fund të vitit 2016, ishte 3.9 milionë euro dhe e shpërndarë në 86 kredi.

Vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 1.8 milion euro. Portofoli ka treguar performancë të cilësisë së lartë pa sinjale të përkeqësimeve.

PORTOFOLI AKTIV



Vlera mesatare e kredisë për klient në fund të vitit ishte nën 50,000 euro. Kjo vlerë është treguese për kategorinë e klientelës që ne besojmë se ka më së shumti nevojë për mbështetje të garancisë së FKGK-së në mënyrë që t'i tejkalojë pengesat e kolateralit.


Është e rëndësishme të ceket se skema jonë e garancisë kreditore është e orientuar drejt segmenteve të ndërmarrjeve komerciale

(ndërmarrje mikro dhe të vogla), që përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit privat të vendit tonë.

Në kuptim të maturitetit, portofoli ynë i kredive të garantuara është i populluar me kredi afatmesme. Ndërsa nga aspekti i produkteve të kredisë, ai përbëhet kryesisht nga kreditë me këste, që tregon se shumica e kredive të shpërndara nën garancinë kishte si qëllim investimin e tyre në asete fikse.

58% e kredive të aprovuara janë investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 31% në tokë, ndërtim ose rinovim; 9% për kapital pune dhe 2% në të tjera.

QËLLIMI I KREDISË




Ne besojmë se ndërmarrjet private në Kosovë, në të gjithë sektorët, qoftë në prodhim, në tregti ose në shërbim duhet të jenë inovative dhe vazhdimisht t'i përmirësojnë proceset e tyre të brendshme.

Përmes investimeve në pajisje të reja, në objekte ndërtimore ose në ekspertizë këto kompani do të forcojnë pozitën e tyre konkurruese

Në fund të periudhës së raportimit, IFR-të kishin garanci kreditore nëpër një gamë të gjerë të sektorëve të biznesit, por sektori më dominues ishte ai i tregtisë me pakicë dhe

shumicë me 33%, i vijuar nga prodhimi me 26%, bujqësi 9% dhe sektorët e tjerë të ndryshëm përbënin 28% të gjithsejtë portofolit të garancisë.

SEKTORËT KRYESORË



Shpërndarja e portofolit të FKKG-së në sektorë të ndryshëm ka ndjekur trendin e njëjtë, i cili dominon në ekonominë e vendit. Ne besojmë se ekonomia jonë duhet të ndërtojë qëndrueshmëri afatgjate në sektorët ku ajo ka përparësi krahasuese.

Megjithatë, mbetet objektivi ynë që në koordinim me bankat partnere t'i orientojmë përpjekjet tona në

forcimin e atyre sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë dhe pavarësi më të lartë nga importi. Një prodhimtari më e fuqishme në veprimtaritë ku vendi ynë ka përparësi krahasuese, si pasojë e zhvillimeve historike dhe natyrore, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në performancë më të mirë të përgjithshme ekonomike në vend.



PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

**Raporti i Auditorëve të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 Dhjetor 2016**

PËRMBAJTJA

FAQE

Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	4
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	7
Shënimet e Pasqyrave Financiare	8 - 18

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

Raport i auditimit të Pasqyrave Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi" apo "FKGK"), që përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, duke përfshirë edhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Fondit më 31 Dhjetor 2016, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që kanë përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Pasiguria materiale lidhur me parimin e vazhdimësisë

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi 2.10 në pasqyrat financiare, i cili tregon që operacionet e Fondit nuk janë të vetëmjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë operimit. Sipas Shënimit 2.10, këto raste apo kushte, bashkë me çështjet tjera siç përcaktohen në Shënimin 2.10, tregojnë që ekziston një pasiguri materiale që mund të krijojë dyshimin e konsiderueshëm ndaj aftësisë së Fondit që të vazhdojë me parimin e vazhdimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat, për gjykimin tonë profesional, kanë më së shumti rëndësi për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit nga ana jonë e pasqyrave financiare si tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi to, si dhe nuk japim opinion të veçantë për këto çështje. Përveç çështjes së shpjeguar tek pika e Pasigurisë materiale në lidhje me parimin e vazhdimësisë, ne kemi përcaktuar çështjet e përshkruara si më poshtë si çështje kryesore të auditimit që duhen komunikuar brenda raportit tonë.

Përveç çështjes së përshkruar tek pika e Pasigurisë materiale në lidhje me parimin e vazhdimësisë, nuk ka çështje të tjera kyçe për t'u komunikuar brenda raportit tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së Fondit për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Fondin apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësimi i prezantimit në përgjithësi, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë informatat e paraqitura, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në atë mënyrë që përbën prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ky raport në Shqip është version i përkthyer i origjinalit në gjuhën Angleze, në rast të mospërputhjeve, origjinali në Anglisht do të mbizotëroj.


BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C.
3 Mars 2017
Rr. Pashko Vasa, Nr.46
10000 Prishtinë, Kosovë

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
ASETET		
Asetet qarkulluese		
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	7,379,611
Llogaritë e arkëtueshme	5	8,209
TOTALI I ASETETEVE		7,387,820
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Detyrimet aktuale		
Tarifat akruale të garancioneve		35,609
Rezerva e humbjeve nga garancionet		10,219
Totali detyrimet aktuale		45,828
EKUITETI		
Kapitali	6	7,345,141
Humbja e akumuluar		(3,149)
Totali ekuiteti		7,341,992
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET		7,387,820


Besnik Berisha
Drejtör Menaxhues




Vjosa Balaj
Menaxhere e Lartë Financiare

	Shënimet	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Tarifat e garancisë	7	7,070
Total të ardhurat		7,070
Provizioni për humbje nga garancionet	8	10,219
Humbja e vitit		(3,149)
Të Ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(3,149)

Shënimet përcjellëse në faqet 8 deri në 18 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave
 financiare.

Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2016

	Kapitali	Humbja e	Totali
	(EUR)	akumuluar	(EUR)
		(EUR)	
Më 1 Janar 2016	-	-	-
Kapitali i paguar	7,345,141	-	7,345,141
Humbja e vitit	-	(3,149)	(3,149)
Më 31 Dhjetor 2016	7,345,141	(3,149)	7,341,992

Shënimet përcjellëse në faqet 8 deri në 18 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave
financiare.

	Shënimet	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese:		
Humbja e vitit		<u>(3,149)</u>
Lëvizjet në kapitalin qarkullues:		
Zvogëlimi / (Rritja) në të arkëtueshme		(8,209)
Rritja / (Zvogëlimi) në akruale		35,609
Rritja / (Zvogëlimi) në rezerva		<u>10,219</u>
Neto paraja e gjeneruar në aktivitetet operuese		<u>34,470</u>
 Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:		
Kapitali i paguar		<u>7,345,141</u>
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		<u>7,345,141</u>
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj		7,379,611
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		<u>-</u>
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	<u><u>7,379,611</u></u>

Shënimet përcjellëse në faqet 8 deri në 18 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave
 financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Programit të USAID-it Fuqizimi i Mbështetjes së Kredive (Empower Credit Support - ECS) i është dhënë mandati për të krijuar FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (FKGK). Përmes “Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore”, Ligji nr. 05/L -057, është themeluar FKGK-ja si institucion i pavarur, jofitimprurës, publik, autonom, subjekt juridik, si dhe janë përcaktuar autorizimet e tij, struktura, qeverisja, operacionet, fushëveprimi, si dhe politikat e procedurat për dhënien e Garancive Kreditore.

FKGK-ja është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojave për qasje më të madhe në financim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit lokal dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, si dhe përmirësimit të bilancit tregtar dhe rritjes së mundësive për financim të NMVM-të.

FKGK-ja është subjekt i pavarur, autonom, juridik i themeluar me Ligj, me subjektivitet të plotë juridik, si dhe identitet ligjor që është i ndarë dhe i ndryshëm nga Bordi Menaxhues dhe Ekzekutivi i FKGK-së.

FKGK-ja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët bashkërisht kanë shumë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e riskut, të drejtën tregtare e financiare, si dhe në auditim. Bordi siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKGK-së.

FKGK-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKGK-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKGK-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve;
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare të Kosovës në FKGK, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare;
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja.
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive të FKGK-së.
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKGK-së brenda kufizimeve të LFKGK-së.
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.

Kapitali minimal i FKGK-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKGK-së.

Organet qeverisëse të FKGK-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKGK-së.

Numri fiskal i FKGK-së është 601642061.

Operacionet e FKGK-së deri më 10 qershor 2017 subvencionohen plotësisht nga Programi i USAID-it për Fuqizimin e Mbështetjes Kreditore, pa eliminuar mbështetjen e mundshme në të ardhmen nga programi, 10 qershori 2017 është data kur FKGK-ja pritet të jetë e pavarur.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuara nga SNRF-ja për çdo lloj asemi, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si më poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave të kontabël të Fondit.

2.2 Ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe shpalosjet

Fondi ka aplikuar, për herë të parë, SNRF 1 dhe disa standarde të ndryshme dhe të reja të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Interpretimet dhe amendamentet e lëshuara nga Komisioni i Interpretimeve të Raportimit Financiar Ndërkombëtar kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë më (apo më vonë se) 1 Janar 2016.

Shënim: jo të gjitha standardet dhe interpretimet e reja të aplikuara për herë të parë për periudhat që fillojnë më (apo më vonë se) 1 janari 2016 kanë zbatim në pasqyrat financiare të Fondit.

- SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Rregullatorët;
- SNRF 10 Pasqyrat financiare të Konsoliduara, SNRF 12 Shpalosja e interesave në Entitetet tjera, dhe SNK 28 Investimet në Ortakëri dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta;
- Amendamentet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja apo Kontributi i Aseteve në mes të një investitori dhe Ortakërie ose Sipërmarrjes të Përbashkët;
- SNRF 11 Amendamentet në Marrëveshjet e Përbashkëta - Blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta;
- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Amendamentet - Iniciativat e Shpalosjeve)
- SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet (Amendamentet - Metodatat e Pranueshme të zhvlerësimit)
- SNK 27 Pasqyrat Financiare (Amendament - Metodatat e Kapitalit në Pasqyrat Financiare të veçanta)
- SNK 38 Asetet e patrupëzuara (Amendamentet - Metodatat e pranueshme të amortizimit);
- SNK 41 Bujqësia (Amendamentet - Fermerët).

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.2 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas përfundimit të vitit më 31 Dhjetor 2016

Më poshtë është një listë e SNFR te ri dhe të rishikuar që nuk janë akoma detyruesisht në fuqi (por lejojnë aplikimin e hershëm) për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016:

- SNRF 9 Instrumentet Financiare;
- SNRF 15 Të hyrat nga Kontratat me Klientët dhe sqarimet përkatëse;
- SNRF 16 Qiratë;
- SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara Amendamentet - Shitja apo Kontributi i Aseteve;
- SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat Amendamentet - Njohja e Asetet e Shtyra Tatimore në Humbjet e Perealizuara;
- SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë Amendamentet në Iniciativat e Shpalosjeve;
- Amendamentet në SNRD 2 Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve për Pagesat e Bazuara në Aksione ;
- SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve Amendamentet - Aplikimi i SNF 9 Instrumentet Financiare;
- SNK 40 Investime në Pronë Amendamentet - Transferimet e Investimeve të Pronës;
- IFIRIC Interpretimi 22 Transaksionet në Valutë të Huaj dhe Trajtimi Paraprak.

Miratimi i këtyre ndryshimeve ndaj standardeve dhe interpretimeve ekzistuese nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat e kontabilitetit të Fondit.

2.3 Asetet financiare

Fondi i klasifikon asetet e veta financiare në këto kategori: asete financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, të mbajtura deri në maturim dhe në asete financiare të disponueshme për shitje. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të veta në vlerësimin fillestar.

Asetet financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes

Asetet financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes janë asete financiare që mbahen për tregtim. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse është siguruar kryesisht për qëllimin e shitjes në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori klasifikohen si asete qarkulluese. Fondi nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato përfshihen në asetet qarkulluese. Në datën e raportimit, kjo kategori përfshinë paratë dhe ekuivalentët e paratë.

2.4 Paraja dhe ekuivalentët e paratë

Paraja dhe ekuivalentët e paratë përfshijnë paratë në dorë dhe balancat në bankë. Fondi ka llogari bankare të hapur në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

2.5 Bilanci i Fondit

Bilanci i Fondit është i siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga USAID si grant.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.6 Tatimi në të ardhura aktuale dhe të shtyra

Sipas LFKGK, Fondi është i përjashtuar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, TVSH-ja dhe tatimi mbi dividendët, interesat ose të ardhurat nga investimet e fituara nga fondet për garancitë ose investimet e kreditit, si dhe çdo detyrim tjetër, mbajtje në burim ose taksë për çdo aspekt të veprimtarisë së Fondit.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet njihen kur plotësohen këto kushte:

- Shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme;
- Është e mundshme që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike;
- Faza e përfundimit të transaksionit në datën e pasqyrës së pozicionit financiar mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
- Kostot e kryera për transaksionin dhe koston e kryerjes së transaksionit mund të maten në mënyrë të besueshme

Të ardhurat e Fondit janë:

- (i) *të ardhurat nga tarifat e garancive*

Tarifat e Garancisë

Pasi që kredia të pranohet dhe të vihet nën garanci, kalkulohet gjithashtu edhe tarifa e garancisë. Tarifa e garancisë kalkulohet në bazë të përqindjes aktuale të garancisë të përcaktuar për një Marrëveshje Garancie shumëzuar me shumën e aprovuar të garancisë. Të ardhurat nga taksa e garancisë njihen në bazë të përlogaritjes për një periudhë prej 12 muajsh.

Tarifat e garancisë njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fund të çdo muaji duke debituar akrualin e Tarifës së Garancisë dhe kredituar Tarifën e Garancisë.

2.8 Provizionimi

Politika e provizionimit specifikon procesin e lënies anash të rezervave të caktuara për të gjitha kreditë që vihen nën garancion, e që priten të kenë apo mund të kenë pasur humbje kreditore. Politika e provizionimit është bërë në përputhje me SNRF 9. Provizionimi i Garancisë Kreditore bëhet në tri faza, bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Informatat e siguruar nga IFR në lidhje me klasifikimin e kredisë do të jenë nxitësi kryesor për lëvizjen e garancisë kreditore në fazë dhe për matjen e riskut kreditor. Provizionimi në fazën e parë bëhet për të gjithë Garancionin Kreditore pa marrë parasysh cilësinë e kredisë, në bazë të humbjes së pritur brenda një periudhe prej 12 muajsh. Garancia kreditore kalon në fazën e dytë (ose nga e dyta në të tretën) nëse ka përkeqësim të konsiderueshëm në cilësinë e kredisë, nëse rrjedha e parasë kontraktuale tek aset financiar nuk është plotësisht e rikuperueshme në rast të dështimit të pagesës. Në të dyja këto faza, provizionimi njihet bazuar në humbjet e pritshme përgjatë gjithë ciklit. Transferimi i aseteve financiare nga njëra fazë në tjetrën është simetrike, që do të thotë se çdo aset financiar mund të zhvendoset, nëse ka përmirësim të konsiderueshëm në cilësinë e kredisë.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.9 Kontingjentet dhe zotimet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato zbulohen vetëm nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por zbulohet kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhme të konfirmojnë një detyrim të tillë të shkaktuar në datën e pasqyrës së gjendjes financiare si dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që shkaktohet.

2.10 Parimi i vazhdimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vazhdimësisë, që nënkupton realizimin e aseteve dhe detyrimeve në veprimtari normale afariste. Operacionet e FKGK-së deri më 10 Qershor 2017 janë plotësisht të subvencionuara nga Programi i USAID-it Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore (Empower Credit Support) pa përjashtuar mbështetjen e mundshme në të ardhmen nga ECS-ja. 10 Qershori 2017 është data kur FKGK pritet të jetë e pavarur. USAID është zotuar të mbështesë pjesërisht shpenzimet operative të FKGK-së pas qershorit 2017. Aftësia e Fondit për të vazhduar në bazë të parimit të vazhdimësisë varet nga aftësia e tij për të siguruar burime të tjera të financimit të operacioneve të veta deri sa të jetë i vete qëndrueshëm. Rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të parashihet në këtë moment. Pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë korrigjimet në vlerat bartëse, klasifikimet e aseteve dhe detyrimeve që mund të jenë të domosdoshme nëse Fondi nuk arrin të vazhdojë me parimin e vazhdimësisë, dhe korrigjimet e tilla mund të jenë materiale.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

3.1 Hyrje dhe të përgjithshme

Risku përkufizohet si efekt i ngjarjeve të pasigurisë dhe rezultateve të tyre që mund të kenë efekt të rëndësishëm tek operacionet e FKGK-së. Menaxhimi i riskut është procesi i vlerësimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me qëllim të reduktimit të atyre rreziqeve deri në nivele të pranueshme. Vlerësimi i riskut bazohet në identifikimin e kërcënimeve, si dhe gjasat që ato kërcënime të realizohen dhe ndikimin e tyre potencial mbi FKGK-në. Menaxhimi i riskut përdor rezultatet e vlerësimeve të rrezikshmërisë për të marrë vendime dhe për të koordinuar aktivitetet për të drejtuar dhe kontrolluar një organizatë në lidhje me riskun.

Politika e Menaxhimit të Riskut e FKGK-së përcakton parimet kryesore për të krijuar një sistem të përshtatshëm të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të riskut. Parimet themelore për menaxhimin e riskut janë të reflektuara në Marrëveshjen e Garancisë, në politikat dhe procedurat ekzistuese, si dhe tek metodologjitë dhe instrumentet për matjen, monitorimin dhe raportimin e riskut. Së bashku, këto formojnë strukturën e menaxhimit të riskut në FKGK-së.

3.2 Struktura e menaxhimit të riskut

Struktura e menaxhimit të riskut të FKGK-së thekson mbikëqyrjen dhe kontrollin e riskut, si dhe përcakton proceset dhe mekanizmat me të cilët merren dhe zbatohen vendimet për rreziqe. Struktura e menaxhimit të rrezikut të FKGK-së fillon me mbikëqyrjen nga Bordi i Drejtorëve. Bordi merr informata të rregullta mbi rreziqet kryesore të FKGK-së bashkë me një përmbledhje gjithëpërfshirëse të profilit të riskut dhe efektshmërisë së portofolit kundrejt qëllimeve të përcaktuara, që i prezantohet në baza tremujore Bordit. Bordi përcakton nivelet maksimale të riskut për rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit, si dhe miraton politikat, kufizimet dhe strategjitë. Bordi gjithashtu siguron që FKGK-ja po merr masat e duhura për të arritur një baraspeshë të kujdesshme ndërmjet riskut dhe përfitimit.

Bordi i Drejtorëve ka themeluar dy komisione për të mbikëqyrur fushat specifike si dhe për të përgatitur temat për shqyrtim nga Bordi: Komiteti i Menaxhimit të Riskut dhe Komiteti i Auditimit.

Komiteti për Menaxhimin e Riskut - komiteti shqyrton dhe dorëzon rekomandime tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me nivelin maksimal të riskut të FKGK-së, politikat e riskut, udhëzimet për riskun, kapitalin, leverazhin, likuiditetin, produktet dhe shërbimet nga këndvështrimi i riskut, si dhe cilësinë kreditore të portofolit të kredive.

Komiteti i Auditimit - komiteti vepron si komitet përgatitor për Bordin e Drejtorëve në lidhje me çështjen e kontabilitetit dhe auditimit, duke përfshirë edhe çështjet e lidhura me riskun.

Në përgjithësi, të dy komitetet e ndihmojnë Bordin e Drejtorëve që të sigurojë menaxhim strikt të riskut brenda FKGK-së, si dhe për të siguruar që menaxhimi dhe raportimi mbi riskun të jenë gjithmonë në përputhje me ligjin dhe parimet e përgjithshme të FKGK-së.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.3 Risku kreditor

Risku kreditor është rreziku i humbjeve që rezultojnë nga dështimi i kredimarrësit që të përmbushë obligimet financiare apo kontraktuale ndaj bankës. Rreziqet e FKKG-së qëndrojnë tek bankat. Nëse kreditë e provizionuara në një bankë të caktuar rriten, duke e vënë portofolin e tyre në rrezik, kjo e rrit edhe rrezikun e FKKG-së, në kuptimin që FKKG-së mund t'i duhet të mbulojë garancitë e lëshuara. Kjo do të ketë ndikim tek pozicioni i kapitalit të FKKG-së si dhe të ardhurat e pritura nga tarifat. Prandaj, vlerësimi i kredive i palëve të FKKG (IFR) dhe politikat e tyre do të ndikojnë në cilësinë e portofolit të garantuar të FKKG-së.

Me qëllim të regjistrimit të institucioneve financiare, FKKG-ja ka implementuar një Politikë Regjistrimi që ka për qëllim të sigurojë regjistrimin vetëm të institucioneve financiare që janë të përgjegjshme dhe transparente, si dhe ofrojnë dëshmi të aftësisë së tyre për të përmbushur kërkesat e FKKG-së. Politika e regjistrimit përcakton parimet kryesore që institucionet financiare duhet t'i kenë për t'u regjistruar në FKKG:

- Bazë të fortë të kapitalit dhe të pozicionit financiar
- Reputacion të mirë në treg
- Vullnet për t'u zgjeruar në segmentin e NMVM-ve
- Vullneti për të zvogëluar kërkesat e kolateralit si reagim i baraspeshuar ndaj garancive të pjesshme të kredive nga FKKG-ja
- Politika e procedura të shëndosha të dhënies së kredive

Për të siguruar zotimet e garancive që merr përsipër FKKG-ja brenda kapacitetit të vet të bartjes së rrezikut, si dhe që portofoli i tij të jetë i diversifikuar mirë, FKKG-ja ka miratuar një Politikë Alokimi. Kjo politikë përcakton fazën maksimale të riskut që FKKG-ja është e gatshëm të marrë përsipër, si dhe vendos metodologjinë e vlerësimit të ekspozimit të IFR-ve. Politika gjithashtu përcakton metodologjinë për vlerësimin e IFR-ve dhe kufijve të alokimit për IFR-të. Metodologjia përcakton që kriteret kryesore për alokimin e një kufiri fillestar janë pjesa e tregut dhe profili i riskut. Megjithatë, kufijtë e ekspozimit mund të korrigjohen nga FKKG-ja. Arsytet për korrigjim do të përfshijnë dështimin për të përdorur kufirin e alokuar në mënyrë të konsiderueshme ose fare, cilësinë e dobët të kredive të dorëzuara për garanci, ose çështje të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë në gjendjen e përgjithshme të bankës.

Me kusht që të kompletohet procesi i regjistrimit, të alokohet kufiri, si dhe të nënshkruhet Marrëveshja e Garancisë, atëherë IFR-ja ka të drejtë të vërë kreditë nën garanci, nëse plotësojnë kriteret e paracaktuara në marrëveshjen e garancisë.

FKKG-ja ka filluar të marrë kredi për garancion në fund të Shtatorit 2016. Në fund të vitit 2016, portofoli ishte si vijon:

	Numri i kredive të dhëna	Gjithsej shuma e kredive të dhëna (EUR)	Shuma e mbetur e kredive (EUR)	Shuma e mbetur e garantuar (EUR)	Shuma e limitit të garancioneve të alokuara (EUR)
Total	86	4,353,500	3,874,629	1,854,406	27,500,000

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.4 Risku i likuiditetit

Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit është thelbësor për të ruajtur besimin e donatorëve dhe IFR-ve, si dhe për të mundësuar që veprimtaria bazë të vazhdojë të gjenerojë të ardhura, edhe në rrethana të pafavorshme. Marrëveshjet e besueshme, analiza e kriterëve të likuiditetit, si dhe planifikimi kontingjent (për shembull një stand-by linjë e kredisë ose një marrëveshje kundër garancisë) janë elemente thelbësore të likuiditetit të fortë.

FKGK thekson që kapitali që ajo mban si asete likuide duhet të sigurojë mbështetjen drejt përbushjes së objektivave të veta. Prandaj është e angazhuar me parimet e arritjes së vlerës për para në menaxhimin e thesarit dhe për përdorimin e teknikave të përshtatshme të matjes së performancës që balancojnë rrezikun dhe shpërblimin, brenda kontekstit të administrimit efektiv të riskut.

Për qëllimet e optimizimit të kthimeve potenciale brenda parametrave të pranueshëm të riskut, FKGK-ja ka përgatitur një politikë investimi që përcakton qartë strukturën e investimeve në përputhje me mandatin e FKGK-së dhe objektivave të tij strategjikë.

31 Dhjetor 2016				
	Deri në 1 vit (EUR)	Aktuale		Mbi 5 vite (EUR)
		1 deri në 2 vite (EUR)	2 deri në 5 vite (EUR)	
Asetet financiare				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7,379,611	-	-	-
Gjithsej asete financiare	7,379,611	-	-	-
Detyrimet financiare				
Të pagueshmet dhe detyrimet tjera	45,828	-	-	-
Gjithsej detyrime financiare	45,828	-	-	-

3.5 Risku operativ

Rreziku operativ përcaktohet si rreziku i humbjes që del nga proceset e papërshtatshme ose të dështuara të brendshme, nga njerëzit dhe sistemet ose nga ngjarje të jashtme. Risku operativ mund të vijë nga një spektër i gjerë i ngjarjeve të ndryshme të jashtme, duk filluar nga dështimet e energjisë e deri tek vërshimet apo tërmetet. Ngjashëm, risku operativ mund të lindë për shkak të ngjarjeve të brendshme, të tilla si potenciali për dështim apo mospërputhje në ndonjërin prej proceseve dhe sistemeve të FKGK-së, apo ndonjërit prej ofruesve të jashtëm të shërbimeve. Risku operativ që rrjedh nga menaxhimi i resurseve njerëzore mund të nënkuptojë një sërë çështjesh, si punëtorët nën menaxhim të dobët apo me trajnim të dobët; potenciali për neglizhencë apo kundërvajtje të qëllimshme; konflikti i interesave; mashtrimi; veprimi armiqësor e kështu me radhë. Menaxhimi i riskut operativ në FKGK fokusohet tek masat proaktive, ashtu që të siguroar vazhdimësinë e punës, por edhe tek saktësia e informatave që përdoren së brendshmi dhe raportohen së jashtmi, një stafi kompetent dhe mirë-informuar, dhe respektimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara, si dhe të masave të sigurisë për të mbrojtur infrastrukturën fizike dhe të teknologjisë në FKGK- së.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.5 Risku operativ (vazhdim)

Sistemi i menaxhimit të riskut operativ në FKGK:

I) Strategji të qarta të miratuara nga Bordi i Drejtorëve, si dhe mbikëqyrje të kontrolluar nga Menaxhmenti i Lartë;
II) Kulturë e fuqishme e brendshme për riskun operativ (kultura e brendshme e riskut operativ nënkupton tërësinë e kombinuar të vlerave, qëndrimeve, kompetencave e sjelljeve individuale e kolektive që krijojnë përkushtimin e institucionit dhe llojin e menaxhimit të riskut operativ), si dhe kultura e kontrollit të brendshëm, që thekson kontrollet e dyfishta;
III) Standarde të larta të etikës dhe integritetit, si dhe
IV) Zotimi ndaj qeverisjes efektive korporatave, që përfshin, mes tjerash, ndarjen e detyrave, shmangien e konflikteve të interesit, si dhe linjat e qarta të përgjegjësisë së menaxhmentit, llogaridhënies dhe raportimit, siç edhe pasqyrohen në dokumentet e qeverisjes së FKGK-së. Të gjitha nivelet e stafit duhet të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me menaxhimin e riskut operativ.

Politikat e sigurimit mund të përdoren për të përballuar humbjet që mund të ndodhin si pasojë e ngjarjeve siç janë pretendimet e palëve të treta që rezultojnë nga gabimet dhe mosveprimet, punonjësit ose mashtrimet e palëve të treta dhe fatkeqësitë natyrore.

3.6 Instrumentet financiare të prezantuara në vlerën e drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së tyre të drejte në deklaratën e gjendjes financiare në pajtim me hierarkinë e vlerës së drejte janë prezantuar në tabelën e mëposhtme. Kjo hierarki i grupon asetet dhe pasivet financiare në tri nivele që janë të bazuara në rëndësinë e të dhënave hyrëse që janë përdorur gjatë vlerësimit të vlerës së drejte të aseteve financiare. Hierarkia e vlerës reale është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimi i kuotuar (jo i rregulluar) në tregjet aktive për asetet dhe pasivet e njëjta
- **Niveli 2:** të dhënat e tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuara, të përfshira në nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për vështrimet e drejtpërdrejta të aseteve apo pasiveve (p.sh çmimet), apo në mënyrë indirekte (p.sh i bërë nga çmimi); dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi asetet dhe pasivet që nuk janë të bazuara në të dhënat të cilat janë në dispozicion për vëzhgimin e tregut.

Më 31 Dhjetor 2016, Fondi nuk ka asete financiare të matura me vlerë reale të drejtë.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.7 Instrumentet financiare që nuk janë prezantuar në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta për ato aktive dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera e bartur 2016 (EUR)	Vlera reale 2016 (EUR)
Asetet financiare		
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	7,379,611	7,379,611
Gjithsej asetet financiare	7,379,611	7,379,611
Detyrimet Financiare		
Të pagueshmet dhe detyrimet tjera	45,828	45,828
Gjithsej detyrimet financiare	45,828	45,828

4. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Paraja në Bankën Qendrore të Kosovës	7,379,611
Gjithsej paraaja dhe ekuivalentet e parasë	7,379,611

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Të arkëtueshme nga klientët	8,209
Gjithsej të arkëtueshme	8,209

6. KAPITALI

Fondet e dhëna FKGK-së janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe USAID-i në formë granti.

Më datën 31 Dhjetor 2016, Fondet përfshijnë:

- Fondet e pranuar nga USAID-i në shumën prej 5,345,141 Euro.
- Fondet e pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë) në shumën prej 2,000,000 Euro.

7. TË ARDHURAT NGA TARIFAT E GARANCIVE

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Tarifat e garancive	7,070
Gjithsej të ardhurat	7,070

Pasi që kredia të pranohet dhe të garantohet, kalkulohet edhe tarifa e garancisë. Tarifa e garancisë kalkulohet në bazë të përqindjes së tarifës aktuale të garancisë specifikuar për një Marrëveshje Garancie (2%), shumëzuar me Shumën e Aprovuar të garancisë. Të ardhurat nga tarifatat e garancisë njihen në baza akruale për një periudhë 12 mujore. Tarifatat e garancive njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fund të muajit, duke debituar Tarifën Akruale të Garancisë, si dhe duke kredituar të ardhurat nga Tarifatat e Garancive.

8. SHPENZIMET E PROVIZIONIMIT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Shpenzimet e provizionimit	10,219
Gjithsej shpenzimet	10,219

Politika e provizionimit specifikon procesin e ndarjes të disa rezervave për të gjitha kreditë që janë të garantuara, e që priten të shkaktojnë apo kanë pësuar humbje nga kredia. Politika e provizionimit bëhet në pajtim me SNRF 9.

9. ZOTIMET DHE KONTINGJENTET

Më 31 Dhjetor 2016 EUR		
	Numri i garancive	Shuma e garantuar e papaguar (EUR)
TOTAL	86	1,854,406

Përveç të tjerave ato që janë shpalosur më sipër, nuk ekzistojnë kontingjencat apo zotime në datën e bilancit.

10. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËLIDHURA

Palët e ndërlidhura janë drejtorët e Fondit. Palët konsiderohen të ndërlidhura nëse një palë e tillë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër, apo të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo operative.

11. NGJARJET PASUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së raportimit, të cilat do të kërkonin korrigjime apo zbulime të informacioneve për këto pasqyra financiare.

Kosovo Credit Guarantee Fund

Address:

Antton Çetta No. 5/A,
10,000 Pristina, Republic of Kosovo

Phone: +381 (0) 38 225 600 ext.208

Fax: +381 (0) 38 225 400

E-mail: info@fondikgk.org

www.fondikgk.org